



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I BASHKISE LEZHE

Bashkia, Lagja "Skënderbeu", Rruga Frang Bardhi, Lezhë - ALBANIA tel/fax: 00 355 215 2270/2570 email : [mayor@lezha.org](mailto:mayor@lezha.org)

**V E N D I M**

**Nr. 111, Datë 27.12.2010**

**PER**

**MIRATIMIN E NIVELIT E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2011**

Bazuar ne ligjin nr.8652, date 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nenet 16 e 44, në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ligjin nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.10117 datë 23.04.2009 dhe ligjin nr.10146 datë 28.09.2009 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave Vendore", **Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Kryetari Bashkisë Lezhë, dhe pas diskutimit të antarëve ;**

**V E N D O S I**

**1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, të vlefshme për vitin 2011, me të gjithë treguesit e saj si më poshtë vijon :**

**Neni 1:**

**Ndarja ne zona**

**1.1.** Për efekt të zbatimit të paketës fiskale, lidhur me aplikimin e tarifave të pastrimit e largimit të mbeturinave urbane, territori i Bashkisë Lezhë ndahet në tre zona : Zona A, e cila përfshin qendrën e qytetit me kufizimet si më poshtë : (1)nga semafori deri të Ura e Cenit si dhe ambjentet e tregtimit dhe të shërbimit në breg të lumit Drin, (rruga Luigj Gurakuqi), (2)nga Ura e Cenit deri në lagjen gurra pranë karburantit Elda (rruga Shtraus), (3)nga kryqëzimi te karburanti Elda e në vazhdim me bulevardin Gjergj Fishta deri te semaforët, (4)nga Librari Kuvendi deri te Ura e vjetër mbi lumin Drin (rruga Fran Bardhi). Zona B, e cila përfshin territorin nën jurisdikcionin e Bashkisë Lezhë me përjashtim të lagjes Nënë tereza dhe lagjia Shehër. Zona C, e cila përfshin vetëm territorin e lagjes Nënë Tereza me kufizime mbi Kishen "Zoja Nuciates"-mbi bar-restorant "Panorama"-mbi "ish-NSHN"-mbi guroren e vjeter, dhe Lagjes Shehër me kufizime mbi Arqipeshkvine-zona e Kalasw – Teqja e Suldive.

**1.2.** Për efekt të zbatimit të paketës fiskale, lidhur me aplikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja si dhe tarifa dysheme për lëshimin me qera të ambjenteve pronë e bashkisë, territori i Bashkisë ndahet në dy zona, Zona A, e cila përfshin qendrën e qytetit me kufizimet si më poshtë : (1)nga semafori deri të Ura e Cenit si dhe ambjentet e tregtimit dhe të shërbimit në breg të lumit

Drin, (rruga Luigj Gurakuqi), (2)nga Ura e Cenit deri në lagjen gurra pranë karburantit Elda (rruga Shtraus), (3)nga kryqëzimi të karburantit Elda e në vazhdim me bulevardin Gjergj Fishta deri te semaforët, (4)nga Librari Kuvendi deri te Ura e vjetër mbi lumin Drin (rruga Fran Bardhi). Zona B, e cila përfshin territorin nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë.

## **Neni 2 Taksat Vendore**

2.1. Niveli i taksave sipas kategorive dhe nenkategorive, agjenti tatimor, kështet e pagesës, madhësia dhe koha e pagimit përcaktohen si më poshtë:

### **2.2. Taksa vendore mbi biznesin e vogel**

*ne 000/lek*

Nr	Emertimi i aktivitetit	Nivelet e xhiros						
		Deri 2000	2000-3000	3000-4000	4000-5000	5000-6000	6000-7000	7000-8000
1	Shitje me pakice	25	48	63	78	93	108	123
2	Shitje me shumice	25	48	63	78	93	108	123
3	Prodhim	23	45	60	75	90	105	120
4	Sherbime	20	43	58	73	88	103	118
5	Profesione te lira	30	53	68	83	98	113	128
6	Ambulant	5	-	-	-	-	-	-

### **2.3. Taksa vendore per automjetet e transportit te udhetareve**

**000/ lek**

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 5 vende	19
2	Automjete 6-9 vende	38
3	Automjete 10-25 vende	44
4	Automjete 26-42 vende	49
5	Automjete mbi 42 vende	52

### **2.4. Taksa vendore per automjetet e transportit të mallrave**

**000/lek**

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 2 ton	28
2	Automjete 2-5 ton	40
3	Automjete 5-10 ton	48
4	Automjete 10-16 ton	50

5	Automjete mbi 16 ton	75
---	----------------------	----

## 2.5. Afatet e pagesës

- 2.5.1. Kësti parë jo më vonë se data 20 prill
- 2.5.2. Kësti dytë jo më vonë se data 20 korrik
- 2.5.3. Kësti tretë jo më vonë se data 20 tetor
- 2.5.4. Kësti katert jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

## 2.6. I ngarkuar për vjeljen e taksës

- 2.6.1. Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë. Kundervajtjet administrative, sanksionet dhe e drejta e ankimit sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9931 datë 09.06.2008 dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008.

## 2.7. Taksa mbi ndertesat

- 2.7.1. Llogaritet mbi bazën e sipërfaqes së ndërtimit në pronësi të taksapaguesit, përfshirë sipërfaqen mbi e nën tokë ose për çdo kat.

Nr	Kategoria / Nenkategoria	Lek/m <sup>2</sup> ne vit
		Niveli i Takses
1	Ndertesa banimi	
	Ndertuar para vitit 1993	10
	Ndertuar gjate ose pas vitit 1993	12
2	Ndertesa te tjera	
	Per tregti (me pakice dhe shumice)dhe sherbime të tjera të gjitha llojeve	150
	Për sherbime administrative dhe profesione të lira dhe ndertesa social kulturore	130
	Ndertesa në sherbim të aktiviteteve prodhuese përpunuese,	30
	Ndertesa në sherbim të OJF- ve	30

- 2.7.2. Siperfaqja në pronësi të çdo subjekti tatimpagues përcaktohet mbi bazën e dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për objektet që mungon një dokumentacion i tillë kjo sipërfaqe përcaktohet me komision të posaçëm, në zbatim të VKB.nr.28 datë 27.06.2007 dhe urdherit të Kryetarit të Bashkisë nr.68. datë 17.07.2007.
- 2.7.3. Në rate të mos pagimit në afat i kësaj takese aplikohet kamatvonesa 0.2% e shumës për çdo ditë si dhe denohet me gjobë në zbatim të ligjit për kundravajtjet administrative.
- 2.7.4. Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

## 2.8. Taksa e fjetjes në hotel.

- 2.8.1. Masa e kësaj takse është 5% e çmimit të fjetjes.

2.8.2. Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

## 2.9. Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja

2.9.1. Percaktohet mbi bazen e vleres ne lekë të ndertimit të ri e koeficienteve ne perqindje si me poshte:

2.9.2. Kjo takse paguhet nga investitori ne nje kest ne momentin e leshimit te lejes se ndertimit. Në raste të mos pageses në afat të kësaj takse aplikohet kamatë vonesa 0.2 % e shumës, që duhet të paguajë deri në 60 ditë, me kalimin e këtij afati kamata llogaritet 1% deri në 30 dite. Në rast se shkelet edhe ky afat KRT-ja vendos masa të tjera deri në anulimin e lejes së miratuar.

2.9.3. Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Urbanistikës e Bashkisë Lezhe.

Nr	Kategoria /Nenkategoria	Koeficienti ne % ndaj vleres se ndertimit	Koeficienti në% ndaj vleres së ndertimit
		Zona A	Zona B
1	Objekte banimi deri në dy kate	1,5	1
2	Objekte sherbimi e tregtie dhe objekte banimi mbi 2 kate	3	2
3	Objekte arsimore, shendetesore, shkencore, administrative e socialkulturore	2	1.5
4	Investime ne infrastrukture	0.1	0.1

## 2.10. Taksa për zënien e hapësirave publike

2.10.1. Kjo takse percaktohet nga Drejtoria e Tatim Taksave mbi siperfaqen në meter katror që do ti jepet për përdorim, pasi të jetë aprovuar kerkesa e subjektit dhe t'i jetë dhënë leja e shfrytëzimit.

2.10.2. Zenie e hapësirës publike per qëllime biznesi ne hapësira publike te administruara nga bashkia të jetë 99 lekë / m<sup>2</sup>/në muaj.

2.10.3. Pagesa e kesaj takse behet me keste mujore, nga momenti i lidhjes se kontrates me Bashkine Lezhe.

2.10.4 Ngarkohet per vjeljen e kesaj takse Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.

## 2.11. Taksa e tableles

2.11.1. Percaktohet si detyrim vjetor ne lekë i subjekteve mbi bazen e kategorive dhe nenkategorive te meposhtme:

Nr	Kategoria /Nenkategoria	Niveli i Takses
1	Tabele për qëllime i dentifikimi fizik/juridik	120 /lek /vit
2	Tabele për qëllime reklamimi,të thjeshta dhe elektronike	22.500 /lekë/m <sup>2</sup> /vit
3	Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj	1.000/lekë/m <sup>2</sup> /ditë

2.11.2. Detyrimi per tabelen paguhet brenda dates 20 Prill te vitit fiskal, ose ne

momentin e hapjes se aktivitetit.

2.11.3. Detyrimi per reklamen paguhet ne nje kest ne momentin e marrjes se lejes per vendosje.

2.11.4. Ngarkohet per mbledhjen e kesaj takse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

### **2.12. Taksa e regjistrimit të automjeteve.**

2.12.1. Niveli i kesaj takse mbetet ne kufijte e percaktuar ne ligjin nr.9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

2.12.2. Agjenti tatimor per vjeljen e kesaj takes eshte DRSHA Laç.

2.12.3. Ngarkohet Drejtoria e Taksave te beje rakordimet me DRSHA Laç per planifikimin dhe vjeljen e saj.

### **2.13. Taksa e regjistrimit te pasurive te paluejtshme.**

2.13.1. Niveli i kesaj takse mbetet ne kufijte e percaktuar ne ligjin nr.9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”

2.13.2. Agjenti tatimor per vjeljen e kesaj takes eshte ZRPP Lezhë.

2.13.3. Ngarkohet Drejtoria e Taksave te beje rakordimet me ZRPP Lezhë per planifikimin dhe vjeljen e saj.

### **2.14. Takse për tavolina të vendosura nga baret e restorantet në hapësira publike pranë ndërtesave ku ato ushtrojnë aktivitetin.**

2.14.1. Niveli i taksës është në masën 100 lekë/tavolinë të vendosur/ditë.

2.14.2. Ngarkohet per mbledhjen e kesaj takse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

## **Neni 3**

### **Tarifat vendore**

**3.1.** Llojet, kategorite, nenkategorite, baza, kestet, koha e pageses dhe organi qe ngarkohet me mbledhjen e tyre percaktohen si më poshtë:

### **3.2. Tarifa e pastrimit dhe e largimit te mbeturinave kategoria “familjarë”.**

3.2.1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë familjare llogaritet e ndarë sipas zonave A, B dhe C, duke ju referuar nivelit të shërbimit që ofrohet sejciles zonë, gjithashtu edhe për subjektet juridike zbatohet ndarja në zona.

**Ne lekë**

Nr	Kategoria/Nenkategoria	Taksa ne lek/vit		
		ZONA A	ZONA B	ZONA C
1	<b>Kategoria familjare:</b>			
	Familje ne ndihme ekonomike, familje me kryefamiljar invalid, veteran te luftes apo qe ka statusin e jetimit.	300	300	300
	Familje te tjera	1.300	650	400

3.2.2. Ngarkohet per mbledhjen e kesaj takse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

3.2.3. Afati i pagesës deri me 30.06.2011.

### 3.3. Tarifa e pastrimit dhe e largimit te mbeturinave kategoria “biznes i vogël”

Ne lekë

Nr.	Aktivitetet/Tarifat	Deri në 2000	2000-3000	3000-4000	4000-5000	5000-6000	6000-7000	7000-8000
1.	Shitjet me pakicë	2500	4800	6300	7800	9300	10800	12300
2.	Njësi Prodhimi	2300	4500	6000	7500	9000	10500	12300
3.	Sherbime	2000	4300	5800	7300	8800	10300	12000
4.	Profesione të lira	3000	5300	6800	8300	9800	11300	12800

3.3.1. Detyrimi paguhet në një kest brenda datës 20 Prill ose në momentin e lindjes fillestare të detyrimit.

### 3.4. Tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave kategoria “biznes i madh”.

Nr.	Llojet e bizneseve	Tarifa në lekë/vit Zona A	Tarifa në lekë/vit Zona B	Tarifa në lekë/vit Zona C
I	Tregtim me shumicë e pakicë, artikuj ushqimor	40000	30000	20000
	Tregtim me shumicë e pakicë, artikuj industrial	30000	20000	15000
II	Njësi sherbimi			
	- Bar –Kafe, Internet Kafe , pube	30000	20000	15000
	- Restorante , Fast –Foode ,Piceri, Pastiçeri etj.	50000	30000	25000
	- Diskoteka e lojra Fati etj.	35000	25000	17000
	-Pika servisi të automjeteve	40000	30000	20000
	-Elektroshtëpiake, sallone bukurie, robagepsi, etj	20000	15000	10000
III	Njësi Prodhimi			
	-Prodhime e punime druri, hekuri e duralumini	40000	30000	20000
	-Prodhime ushqimore, bukë, mish,peshk, bumet	50000	40000	25000
	-Thertore , perpunim tregtim vjajrash, naftë, gazi e nënprodukte të tyre, shtypshkronja etj.	50000	40000	25000
IV	Subjekte Ndertuese			

	-Për selit administrative	20000	15000	10000
	-Ndertim objekte të reja nga një deri në pes kate (ngritje kantieresh )	50000	35000	25000
	- Ndertimet mbi 5 kate	100000	70000	50000
	Profesionet e lira, institucionet arsimore, shendetesore, kulturore e sportive private	8000	6000	4000
	Hotele, motele, komplekse turistike, zyra administrative etj, te ngjashme me to ne lek/dhome/vit	500	400	250

3.4.1. Afati i pagese deri 31.03.2011 për të gjitha subjektet juridike.

3.4.2. Ngarkohet per mbledhjen e kesaj takse Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.

3.4.3. Subjektet që kanë dy ose më shumë aktivitete, tarifa e pastimit për aktivitetet e tjera, të llogaritet 50% e tarifës së përcaktuar në tabelën e mësipërme, për çdo aktivitet shtesë.

3.4.4. Ngarkohet per mbledhjen e kesaj takse Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.

### **3.5. Tarifa e gjelbërimit, ndriçimit, dhe dekorit të qytetit. kategoria “Biznes i madh”**

Nr.	Llojet e bizneseve	Tarifa në lekë/vit Zona A	Tarifa në lekë/vit Zona B
I	Çdo lloj aktiviteti	3.000	2.000

3.5.1. Afati i pageses deri me 31.03.2011.

### **3.6. Tarifa e parkimit te automjeteve në vendparkimet publike me pagese.**

Nr	Automjete në shërbimin e transportit publik	Tarifa ne lek sipas kohes se parkimit	
		Parkim i rezervuar 1 vit	
1	Autobuza	20.000	
2	Minibuza	15.000	
3	Autovetura	8.000	

Nr	Autovetura jashte transportit publik	Tarifa ne lek sipas kohes se parkimit	
		Brenda dites	Parkim i rezervuar 1 vit
3	Autovetura	50	10.000

3.6.1. Për vjeljen e të ardhurave për vendet e rezervuara ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

### **3.7. Tarifa maksimale për transportin e udhëtarve me taksi në zona urbane nga ora 06:00-21:00.**

3.7.1. Tarifa fillestare për distancën deri në 2 km të jetë 300 lekë. Për çdo udhëtar shtese nga nisja, shtesa në lekë nga taksisti duhet të jetë 150 lekë.

3.7.2. Tarifa për distancën deri në 14/km të jetë 1.600 lekë ose 114.3 lekë/km.

3.7.3. Tarifa mbi 14 km deri në 30 km të jetë 3.400 lekë ose 118/lekë/km

3.7.4. Tarifa mbi 30 Km të jetë 153 lekë për çdo km

### **3.8. Tarifa maksimale të udhëtimit në zonat jo urbane nga ora 06:00 – 21:00.**

3.8.1. Tarifa fillestare deri në 2 km të jetë 350 lekë. Për çdo udhëtar shtesë aplikohet 50% e tarifës fillestare.

3.8.2. Tarifa deri në 14 km të jetë 1.350/lekë, ose 96.4 lekë/km.

3.8.3. Tarifa mbi 14 km deri 30 km të jetë 2.950 lekë, ose 92/km.

3.8.4. Tarifa mbi 30 km të jetë 133 lekë/km.

3.8.5. Për çdo udhëtim në tarifimin e taksimetrit nga drejtoria e kalibrimit vëndoset tarifa fillestare e udhëtimit deri në 2 km e para plus sipas distancës përshkruar në pikat b,c,d,

3.8.6. Për shërbime të kryera pas orës 21:00 deri në orën 06:00 si dhe në ditët e djela e festa zyrtare çdo tarife udhëtimit t'i shtohet 10% e vlerës.

### **3.9. Tarifa për shërbimet administrative:**

3.9.1. Shërbimi i arkives.

3.9.1.1. Ekstrakt vendim keshilli e vertetime të arkivit, të jetë 100 lekë për çdo dokument të lëshuar.

3.9.1.2. Dokument vertetim pronësie, të jetë 200 lekë për çdo dokument të lëshuar.

### **3.10. Tarife shërbimi për tregjet publike**

3.10.1. Shites artikuj industrial 1.000 lek/muaj.

3.10.2. Shites artikuj ushqimorë 1.500 lek/muaj.

3.10.3. Shites artikuj bulmeti e mish 2.000 lek/muaj.

3.10.4. Shites ditore të jetë 100 lekë/m<sup>2</sup>/në ditë.

3.10.5. Ngarkohet për vjeljen e detyrimeve, agjenti tatimor që ndjek shfrytëzimin e tregut publik, sipas kontratës me Bashkinë Lezhë.

### **3.11. Për dhënien e licensave perdoren tarifat si me poshte:**

3.11.1. Dhënie certifikate transport mallrash e pasagjerësh të jetë 3.000 lek/mjet.

3.11.2. Dhënie autorizimi për transport nderqytetas të jetë 2.000 lek/mjet.

3.11.3. Autorizim shitje karburanti me pakice të jetë 50.000 lek.

3.11.4. Leje për shërbim me orar të zgjatur apo 24 orësh, të jenë 10.000 lek/muaj.

3.11.5. Për vjeljen e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.



### **3.12. Tarifa ne fushen e urbanistikes**

- 3.12.1. Pranim dosje per shqyrtim per te gjitha llojet e aplikimeve
  - 3.12.1.1. per nevoja biznesi të jetë 5.000 lek
  - 3.12.1.2. per shtepi banimi të jetë 2.000 lek
  - 3.12.1.3. për ndryshim destinacioni të jetë 2.000 lekë
- 3.12.2. Terheqje dokumentash te njesuar me origjinalin nga arshiva teknike dhe ajo e kadastres urbane, të jetë 100 lekë për çdo dokument të lëshuar.
- 3.12.3. Tarifa për Fasaden e objekteve të jetë 30/lek/m<sup>2</sup>
- 3.12.4. Kontroll i piketimit te objekteve të jetë 5.000 lek
- 3.12.5. Kontroll i piketimit te objekteve shtepi banimi të jetë 2.000 lek
- 3.12.6. Kontroll pas perfundimit te themeleve të jetë 5.000 lek
- 3.12.7. Kontroll pas perfundimit te karabinase të jetë 1.500 lek/kat
- 3.12.8. Kontroll mbi sistemimin e ambientit rrethues pas perfundimit te punimeve të jetë 1.000 lek
- 3.12.9. Akt kontroll i perfundimit te punimeve per leje shfrytezimi:
  - 3.12.9.1. objekte deri 5 kate të jetë 8.000 lek.
  - 3.12.9.2. objekte mbi 5 kate të jetë 8.000 lek + 1000 lek/kat.
- 3.12.10. Fotokopjim planshetash ne shkallen 1/500; 1/200
  - 3.12.10.1. format A4 të jetë 100 lekë
  - 3.12.10.2. format A3 të jetë 200 lekë
  - 3.12.10.3. format A2 të jetë 400 lekë
  - 3.12.10.4. format A1 të jetë 1.000 lekë
  - 3.12.10.5. format A0 të jetë 2.000 lekë
- 3.12.11. Azhornim genplanesh per leje ndertimi 40 lek/m<sup>2</sup>;  
ne objektet e veçuara 10 lek/m<sup>2</sup>
- 3.12.12. Genplan i paazhornuar format A4=1000 lek; format A3= 2000 lek
- 3.12.13. Matje e percaktim i zones se vendndodhjes se objektit,  
azhornim i genplanit 3000 lek
- 3.12.14. Azhornime per reklama e zenie hapesirash publike 2.000 lek
- 3.12.15. Per vjeljen e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Urbanistikes.

### **3.13. Tarifa te Inspektoriatit Veterinar**

- 3.13.1. Çertifikate lejim konsumi te peshkut e produkteve te detit të jetë 100 lek/rast.
- 3.13.2. Vulosja e mishit dhe paisja me raport veterinar per kafshet e trasha të jetë 100 lek/krere.
- 3.13.3. Vulosja e mishit dhe paisja me raport veterinare per derrat e kafshet e imta të jetë 100 lek/krere.
- 3.13.4. Në zbatim të ligjit për “Kundravajtjet administrative”, për çdo kundravajtje e shkelje të legjislacionit veterinar, ushqimor dhe të mjedisit, të vendoset masa e gjobës nga 500 deri në 10.000 lekë.
- 3.13.5. Per vjeljen e kesaj tarife ngarkohet Zyra e Inspektoriatit Veteriner.

### **3.14. Tarifa sherbimi per institucionet e varesise:**

- 3.14.1.** Përdorimi i ambjenteve në Pallatin e Kulturës “Manush Alimani” të ketë këto tarifa, sipas sallave.
  - 3.14.1.1. Salla e leksioneve të jetë 3.000 lek për çdo orë përdorimi.
  - 3.14.1.2. Salla e madhe të jetë 20.000 lek/ora
  - 3.14.1.3. Per shfaqjet të organizuara nga institucioni për publikun të jetë 200

lekë/person.

- 3.14.1.4. Përdorimi i sallave për zhvillime provash të jetë 300/lekë /ora .
- 3.14.1.5. Salla e Galerisë së arteve për ekspozitatë jetë 3.000/lekë për çdo ditë përdorimi.
- 3.14.1.6. Për piktoret e rinj e talentet e reja të jetë 1000/lekë /ditë

### **3.14.2. Biblioteka Publike e Qytetit.**

- 3.14.2.1. Holli në katin e dytë të jetë 3.000 lekë për çdo ditë përdorimi.
- 3.14.2.2. Hapje kartele lexuesi të rregullt të jetë 100 lekë.
- 3.14.2.3. Hapje kartele lexuesi për fëmijet falas

### **3.14.3. Çmimet e biletave për të frekuentuar ndeshjet e futbollit të Klubit Sportiv “Beslidhja”**

3.14.3.1. Ndeshje kombetare:

- 3.14.3.1.1. Tribuna A e B ( e mbuluar) 200 lek
- 3.14.3.1.2. Tribuna A e B (e pambuluar) 150 lek
- 3.14.3.1.3. Tribuna perballë 100 lek

3.14.3.2. Ndeshje nderkombetare

- 3.14.3.2.1. Tribuna A e B ( e mbuluar) 500 lek
- 3.14.3.2.2. Tribuna A e B (e pambuluar ) 400 lek
- 3.14.3.2.3. Tribuna perball 300 lek

**3.14.4.** Per dhenien ne shfrytezim te mjediseve sportive tarifa të jetë 50.000 lekë për çdo aktivitet të zhvilluar.

**3.14.5.** Ngarkohen per mbledhjen e ketyre tarifave administrata e institucioneve vartese, si dhe drejtoria e finances per evidentim e kontroll.

**3.14.6.** Për dhenjen me qera të objekteve pronë e Bashkise në zbatim të VKM nr.1712, datë 24.12.2008, VKB nr.67, datë 15.12.2008, rekomandimet e KLSH-së, duke ruajtur ndarjen në zona, çmimet dysheme për dhënien me qera të jenë

3.14.6.1. Zona A çmimi të jetë 350/lekë/m<sup>2</sup>

3.14.6.2. Zona B çmimi të jetë 250 /lekë/m<sup>2</sup>

## **Neni 4**

### **Dispozita te veçanta**

4.1. Kur taksat mblidhen nga Agjenti fiskal, ai te shperblehet ne masen deri në 10% te vleres se arketuar prej tij. Kryetari i Bashkise perzgjedh dhe lidh kontrata me agjentin fiskal.

4.2. Taksa e tabelës, Taksa te perkohshme vendore, Tarifa vjetore e pastrimit urban, Tarifa e sherbimit per ndricim dhe gjelberim ne qytet do te arkëtohet nga tatimpaguesi brenda 4 - mujorit te pare te vitit ushtrimor.

4.3. Per subjektet qe rregjistrohen per here te pare gjate vitit ushtrimor, niveli i taksës do te jete proporcionalisht me pjesen e mbetur te vitit.

4.4. Kryetari i Bashkise nxjerr urdhra perkates per zbatimin e ketij vendimi, brenda 30 ditëve nga rija në fuqi e tij.

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Drejtoria e Urbanistikes, Drejtoria e Finances, Drejtoria e Burimeve Njerezore, Drejtoria e Kultures, Arsimit, Turizmit e Sportit dhe Drejtuesit e Institucioneve vartese.
3. Policia Bashkiake ngarkohet te mbeshtese sipas rregullave te percaktuara ligjore, inspektoret e të gjithë Drejtorive të përmundura në nenin 5 për realizimin e te ardhurave nga taksat e tarifat vendore.
4. Ky vendim i shtrin efektet finaciare nga data 01 janar 2011.
5. Vendimet e Këshillit të Bashkisë Lezhë, nr.66, datë 19.12.2007, nr.67, datë 15.12.2008 dhe nr.70, datë 28.12.2009 shfuqizohen.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI  
FRANO KULLI**